



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT

LLOGARI PAGESORE ME FUNKSIONE BAZË



Çfarë është llogaria pagesore me funksione bazë?

Llogaria pagesore me funksione bazë është një **llogari pagesore në denarë** e cila qytetarëve iu mundëson:

- hapjen, mbajtjen dhe mbylljen e llogarisë pagesore;
- numër të pakufizuar të pagesave të mjeteve në llogarinë pagesore;
- numër të pakufizuar të transaksioneve pagesore:
 - debitime direkte,
 - përdorim të kartelave pagesore, përfshirë edhe onlajn,
 - transferime kreditore, përfshirë edhe urdhëresa të përhershme, nëpërmjet terminaleve bankare dhe sporteleve në ambientet e punës së bankës ose kursimoreve dhe me përdorimin e internetit dhe aplikacionit celular.

Cili është dallimi mes llogarisë pagesore me funksione bazë dhe llogarisë së "zakonshme" pagesore?

Llogaria pagesore me funksione bazë ka funksione të ngjajshme sikur llogaria "e zakonshme" pagesore, ku në llogarinë pagesore me funksione bazë **nuk lejohet mbitërheqja**, pra hyrja në të ashtuquajturin "minus bilancor". Me fjalë tjera në llogarinë me funksione bazë në dispozicion i keni vetëm mjetet të cilat i posedoni, me qëllim që, për të realizuar pagesa duhet të jeni të sigurtë se keni mjete të mjaftueshme personale në llogari, në të kundërtën pagesa nuk mund të realizohet.

Llogaria pagesore me funksione bazë mund të jetë vetëm në denarë, për dallim të llogarive tjera pagesore të cilat mund të jenë në një ose më shumë valuta të ndryshme nga denari.

Llogaria pagesore me funksione bazë **nuk përfshin kartelë kreditore** dhe nëse konsumatori dëshiron ta përdorë, mund të lidhë marrëveshje të veçantë për atë.

Llogaria pagesore me funksione bazë mundëson realizimin e llogarive pagesore njëjtë sikur se edhe llogaritë tjera: depozitimin dhe tërheqjen ditore të parave të gatshme, pagesën e faturave për shërbimet komunale dhe shërbimeve tjera, detyrimet publike dhe të tjera ose me përdorimin e kartelave pagesore debitore për blerje në vendet fizike të shitjes ose nëpërmjet internetit.

A paguhet tarifë për llogarinë pagesore me funksione bazë?

Po, për përdorimin e llogarisë pagesore me funksione bazë paguhet tarifë, për të cilën rekomandohet që para lidhjes së marrëveshjes kornizë të lexohet tarifa ekzistuese dhe të informoheni për shumën të cilën do t'ju ngarkohet. Tarifat ekzistuese të bankave dhe kursimoreve janë të disponueshme në ambientet e tyre të punës ose në faqet e internetit.

Për shërbimet e përfshira me llogarinë pagesore me funksione bazë, banka ose kursimorja mund të llogarisë dhe të ju ngarkojë **me një tarifë mujore në një lartësi të caktuar të arsyeshme** e cila nuk mund të jetë më e lartë se 0,1% nga mesatarja lëvizës e pagës mesatare neto në vend për 12 muajt e fundit, në pajtim me publikimet e Entit Shtetëror të Statistikave. Kjo tarifë përfshin mbajtjen e llogarisë pagesore dhe kartelës debitore, përdorimin onlajn dhe aplikacionin celular, numër të pakufizuar të transaksioneve pagesore për pagesë ose tërheqje të parave të gatshme direkt nga sportelet në ambientet e punës së bankave ose kursimoreve ose nëpërmjetet rrjetit të ATM-ve, numër të pakufizuar të transaksioneve me kartela debitore dhe realizimin e minimum pesë transaksioneve pagesore me transferim kreditor, përfshirë edhe urdhëresë të përhershme dhe me debitimin direkt me të cilat transmetohen mjete në llogari tjera pagesore te banka ose kursimorja e njëjtë.

Bankat dhe kursimoret duhet **falas ti informojnë qytetarët** për shërbimet pagesore dhe tarifat të cilat ju ngarkohen për përdorimin e llogarisë pagesore me funksione bazë për të cilën janë të obliguar t'ju japin një dokument informativ për tarifat para lidhjes së marrëveshjes kornizë. Qytetarët do të mund të informohen për tarifat të cilat bankat dhe kursimoret i ngarkojnë për llogarinë pagesore me funksione bazë edhe në faqën e internetit të Bankës Popullore **duke filluar nga shtatori i vitit 2023**, ku do të **publikohen dokumentet informative për tarifat e çdo banke ose kursimore.**

A mund të hapet llogari pagesore me funksione bazë te cili do ofrues i shërbimeve pagesore?

Qytetari mund të hap **llogari pagesore me funksione bazë te banka ose kursimorja**, me parashtrim të kërkesës për hapje të llogarisë pagesore me funksione bazë dhe bashkangjit një deklaratë se nuk ka hapur llogari tjetër pagesore në denarë te banka e njejtë ose një tjetër bankë ose kursimore në vend. Gjithashtu, qytetari mund të kërkojë transformimin e llogarisë së “zakonshme” pagesore në llogari pagesore me funksione bazë te e njejta bankë ose kursimore.

Çka është llogaria pagesore me funksione bazë për konsumatorët të cilat i takojnë grupit të përdoruesëve me të drejta ligjore?

Llogaria pagesore me funksione bazë për konsumatorët të cilët i takojnë grupit të përdoruesëve me të drejta ligjore është llogari me funksione bazë për të cilët nuk llogaritet dhe **nuk ju ngarkohet tarifë** për grupin e shërbimeve të cilat i përfshin dhe janë shpjeguar më lartë, nëse konsumatori i takon grupit të përdoruesëve me të drejta ligjore vijuese:

- alimentacion ligjor, kompensim për dëmin e shkaktuar për shkak të dëmtim të shëndetit ose uljen, pra humbjen e aftësisë punuese dhe kompensim të dëmit për humbje të alimentacionit shkaku i vdekjes së ofruesit të alimentacionit;
- kompensim për shkak të lëndimit trupor sipas rregulloreve për sigurimin e aftësisë së kufizuar;
- ndihmë financiare nga mbrojtja sociale;
- papunësia e përkohshme;
- shtesa për fëmijë dhe
- bursa, kredi dhe ndihmë e nxënësve dhe studentëve.

Cilat janë përfitimet nga posedimi i një llogaria pagesore me funksione bazë?

Konsumatorët do të mund të përdorin **një grup relativisht të gjërë të shërbimeve pagesore** të cilat i ofrojnë bankat ose kursimoret për të cilat do të paguajnë tarifa me një shumë të arsyeshme. Njëkohësisht, **ligjërisht është kufizuar shuma e tarifës** që do të paguajnë për përdorimin e këtyre shërbimeve pagesore. Gjithashtu, konsumatorët të cilët janë përdorues me të drejta ligjore të caktuara këtë grup të shërbimeve pagesore mund ta marrin falas. Në këtë mënyrë, lehtësohet qasja deri te shërbimet e bankave dhe kursimoreve me qëllim të realizimit të pagesave të tyre ditore.

A mund të refuzohet kërkesa për hapjen e llogarisë pagesore me funksione bazë?

Banka ose kursimorja nuk ka të drejtë ta kushtëzojë hapjen dhe përdorimin e llogarisë pagesore me funksione bazë me përdorimin shtesë të shërbimit dhe/ose produktit, as edhe me blerjen e aksioneve ose letrave me vlerë të emetuara nga ajo ose nga persona me të cilët ka lidhje të afërta.

Megjithatë, **kërkesa për hapje të llogarisë me funksione bazë** mund të **refuzohet** nëse konsumatori ka hapur llogari pagesore në denarë te e njejta ose ndonjë bankë ose kursimore tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila i mundëson ti përdorë shërbimet pagesore me funksione bazë ose nëse vendosja e marrëdhënies afariste me konsumatorin të cilin e ka paraqitur kërkesën është në kundërshtim me rregulloret me të cilat rregullohet zbulimi dhe parandalimi i larjes së parave dhe financim të terrorizmit.

Banka ose kursimorja duhet ta merr vendimin për hapje ose refuzimin e kërkesës për hapje të llogarisë pagesore me funksione bazë, **në afat prej dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës.**



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

info@nbrm.mk

<https://www.nbrm.mk/>